

Z. Alush Zaçe Kryeauditues

Zoti Alush Zaçe është Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit prej datës 03.01.2018. Ka filluar të punojë pranë këtij institucioni në Korrik 2012 dhe ka ushtruar funksione të ndryshme, si auditues, kryeauditues dhe Drejtor Departamenti.

Në periudhën 1998-2012 ai ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve në pozicione të ndryshme, si specialist, përgjegjës sektori, Drejtor Drejtorie dhe Oficer projekti në Njësinë e Zbatimit të Projekteve të Transportit me financim të Qeverisë Italiane. Në këtë institucion ai ka ndjekur probleme të ndryshme për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor të Republikës së Shqipërisë.

Në periudhën 1993 – 1998 ka punuar në Bashkinë e Vlorës si Kryetar I Njësisë Administrative nr. 2, ku ka ndjekur probleme të ndryshme që I përkasin Pushtetit Vendor.

Në periudhën 1989 – 1992 ka punuar në Ndërmarrjen Komunale Banesa të qytetit të Burrelit, ku ka ndjekur zbatimin e investimeve në banesa, ujësjellës dhe infrastrukturë rrugore.

Zoti Zaçe është diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Ndërtime Civile dhe Industriale, në vitin 1989. Ai gjatë karrierës së tij profesionale, para dhe gjatë punës në KLSH, ka marrë pjesë në disa konferenca, seminare dhe workshope të organizuara nga organizma dhe projekte ndërkombëtare në Londër, Shkup, Paris, Stamboll, Varshavë, etj.

Gjithashtu, ai ka marrë pjesë në konferenca, trajnime dhe seminare brenda dhe jashtë vendit, që kanë të bëjnë me organizimin e Auditimit të Performancës, Auditimin e Mjedisit.